

# DEPOJA E KEQPËRDORIMEVE FARMACEUTIKE

**Blerjet e barnave të listës esenciale  
shumëfish më shtrenjtë sesa çmimet në treg**





## Rreth Institutit Columbus

Instituti Columbus është organizatë e pavarur, joqeveritare dhe kërkimore, që mbledh rreth vetes hulumtues e kontribuues të tjerë nga fusha ekonomike, politike dhe shoqërore në Kosovë, me qëllim të ofrimit të një platforme mendimi kritik dhe veprimi proaktiv në proceset zhvillimore të vendit.

### Raporti:

### Depoja e keqpërdorimeve farmaceutike

Blerjet e barnave të listës esenciale shumëfish më shtrenjtë sesa çmimet në treg

### Autore:

Saranda Ramaj



Maj 2018

Prishtinë, Republika e Kosovës

Shënim: Instituti Columbus është anëtar i koalicionit për Hapje të të Dhënave dhe Llogaridhënie në Prokurim Publik – Pro Open, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS

Ky hulumtim është pjesë e programit "Pro Open". Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të Institutit Columbus dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS.



Pro Open  
Koalicioni për Hapje të të Dhënave dhe Llogaridhënie në Prokurim Publik



**KFOS**

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

# Përmbajtja

Përmbledhje.....	4
Hyrje.....	4-5
Rritja e çmimeve te barnat.....	5-8
Rritja e çmimeve te materiali shpenzues.....	9-11
Shteti legjitimoi monopolin.....	12-13
Problemet në OSHP.....	13-14
Përfundimet .....	15
Rekomandimet.....	16
Të dhënat tabelare.....	17-22

## Shkurtesat:

<b>AKPPM</b>	Agjencioni Kosovar për Produkte dhe Pajisje Mjekësore
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>SHSKUK</b>	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
<b>QKUK</b>	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
<b>OSHP</b>	Organi Shqyrtues i Prokurimit
<b>KRPP</b>	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
<b>OE</b>	Operatori Ekonomik
<b>AK</b>	Autoriteti Kontraktues
<b>ZP</b>	Zyrtar i Prokurimit
<b>LE</b>	Lista Esenciale

# Përmbledhje

Shëndetësia në Kosovë që nga paslufta, është përcjellë nga nën buxhetimi. Por, edhe buxheti i dedikuar për këtë fushë në shumë raste është keq menaxhuar. Ministria e Shëndetësisë është një nga institucionet e cila ka me së shumti zyrtarë të akuzuar <sup>1</sup>. Në veçanti shumë të akuzuar ka nga fusha e prokurimit në këtë sektor. Buxheti në vitin 2016 dhe 2017 për institucione spitalore publike është rreth 21 milionë euro<sup>2</sup>. Edhe pse viteve të kaluara ka qenë buxheti përafërsisht i njëjtë, në këta dy vjet, të cilët i ka analizuar Instituti Columbus, ka pasur furnizim me të ulët me barna dhe material shpenzues nga Lista Esenciale. Në vijim të këtij raporti, do të argumentohen ndryshimet se çka kanë ndodhur në fushën e prokurimit të barnave. Njëra nga gjetjet kryesore të raportit është rritja e befasishme e çmimeve të barnave për sektorin publik, por një rritje e tillë nuk ka reflektuar ende në tregun privat. Kësisoj, nëse krahasohen kontratat e dy vjetëve të fundit me vitet paraprake, vërehen çmime aktuale astronomike. Për më tepër, janë kompanitë e njëjta të cilat produktin e njëjtë, me sasi e dozë të njëjtë në vitin 2015 ua kanë shitur spitaleve publike deri në 2-fish më lirë. Furnizimi me barna është i kufizuar. Mund të merren 50% të kërkesave të tyre. Nuk është e qartë nëse barnat nuk janë blerë kurrë (për shkak të mungesave buxhetore) ose janë drejtuar për shitje në sektorin privat ose të dyja. Stafi i mëparshëm i MSH-së është akuzuar për korrupsion me barna (drejtori i shërbimit farmaceutik spitalor). Operatorët ekonomikë tani shpërndajnë barna për nivelin e sekondar dhe terciar drejtpërdrejt në objektet e tyre, në bazë të kërkesave të spitaleve dhe me miratimin e Agjencisë së Financimit të Shëndetësisë. Mungesa e furnizimeve me barna mund të jetë për shkak të sasive të vogla të kërkuara nga institucionet shëndetësore dhe ndëshkimet/masat mbrojtëse të pamjaftueshme në kontrata për vonesa të furnizimit. Në prokurim ka ndërrime të stafit, numër të pamjaftueshëm të stafit dhe mungesë të mundshme të kapaciteteve për mbikëqyrje teknike (d.m.th. përcaktimi i nevojës, vendosja e specifikimeve). Shfrytëzimi joracional është problem më vete dhe ka shqetësime rreth motivimit financiar për përshkrimin e recetave dhe referimet.

## Hyrje

Instituti Columbus ka filluar monitorimin e prokurimit të barnave në pjesën e dytë të vitit 2017, duke pasur parasysh se shëndetësia konsiderohet si një ndër fushat me më së shumti korrupsion. Gjatë periudhës së monitorimit Columbus, ka arritur të identifikojë një numër të madh të problemeve që e karakterizojnë këtë fushë. Problemet në fushën e prokurimit të barnave kanë efekt të drejtpërdrejtë të pacientët të cilët si pasojë e këtyre problemeve mbesin pa barna. Zinxhiri i furnizimit me produkte medicinale përfshin proceset për përzgjedhje, prokurim, shpërndarje dhe përdorim të produkte medicinale në procesin e trajtimit. Zyrat qeveritare dhe zyrtarë publikë janë të përfshirë në të gjitha këto aktivitete, si dhe në rregullimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve medicinale përmes licencimit të barnave dhe barnatoreve. Një ndër parimet kryesore të procedurave të prokurimit është shfrytëzimi i mirë buxhetit publik. Në rastin tonë, Ministria e Shëndetësisë, si Autoritet Kontraktues, duhet të përkujdeset që buxheti për barna të shfrytëzohet në mënyrë sa më racionale të mundshme. Por një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Ministria e Shëndetësisë për këto vite nuk ka vendosur një "tavan" për çmimet e barnave. Kjo ka bërë që të mbetet në duart e operatorëve ekonomikë që të ofertojnë barnat sipas dëshirës së tyre. Kjo ministri, deri në fund të vitit 2017, ka pasur në dispozicion rreth 21 milionë euro për furnizim me barna dhe material shpenzues<sup>3</sup>. Një pjesë e madhe e këtij buxheti (deri në rreth 40 për qind u dedikohet citostatikëve, barna për trajtimin e kancerit). Në periudhën raportuese, Instituti Columbus ka vërejtur se proceset për blerjen e barnave që në fillim nisin me probleme. Kjo ministri këto vite, kur është analizuar procesi i prokurimit, tenderët i ka hapur me vonesë (vetëm kur institucioni ka mbetur pa kontratë). Kësisoj, ka pasur raste kur tenderi është hapur tre muaj pas përfundimit të kontratës paraprake, ndërsa kontrata e re nuk është nënshkruar edhe 18 muaj pas shpalljes së tenderit. Të tilla vonesa dhe ngritjet e çmimeve, pos që lënë spitalet pa barna, nënkuptojnë miliona euro humbje të buxhetit të shtetit e humbje të mëdha parash për pacientet që kanë nevojë për këtë terapi.

## Rritja astronomike e çmimeve të barnave

Institucionet publike shëndetësore, prej pas luftës, nuk kanë arritur ta përmbushin listën esenciale me barna, për shkak të buxhetit të ulët që ka Ministria e Shëndetësisë, dedikuar furnizimit me barna. Por, pavarësisht kësaj, shpeshherë ndodh që manipulimet me barna, si blerja e tyre me çmim shumëfish më të shtrenjtë se vlera reale, të mos mungojë. Miliona euro barna kanë shkuar te disa Kompani Farmaceutike për furnizim me spitale në vitin 2016 dhe atë 2017. Por me të njëjtat miliona, janë blerë më pak barna sesa viteve të kaluara. Kësisoj, Instituti Columbus do të prezantojë disa shembuj se si është rritur çmimi pa asnjë arsye. Noraderenlina ( sinonim me norepinefrinën ) është neurotransmiteri kryesor i sistemit nervor simpatik, përgjegjës për ndryshimet tonike dhe refleksive kardiovaskulare<sup>4</sup>. Në SHSKUK përdoret në formë ampule që injektohen tek pacientet. Përafërsisht brenda një viti, përdor 700 njësi në kuadër të SHSKUK-së. Në vitin 2015, për një njësi të këtij produkti është paguar 2.78 euro. Për të njëjtin produkt në vitin 2016 është paguar 22 euro. Në këtë mënyrë, MSH-ja e ka kontraktuar një produkt për 800 për qind/ Nëse bëhet një llogaritje e thjeshtë, del se brenda një viti, për këtë produkt në vitin 2015 janë paguar 1960 euro. Por, nga viti 2016, për të njëjtën sasi, për të njëjtin produkt, MSH-ja paguan 15.400 euro. Nëse merret parasysh që në MSH kontratat me të shpeshta kanë kohëzgjatje 36-mujore, del se me kontratat e reja, MSH-ja do të paguajë 46 mijë e 200 euro, ndërsa me kontratat e vjetra me të njëjtën kohëzgjatje të kontratës janë paguar 5 mijë e 880 euro. Pra, kontrata e vjetër për këtë produkt ka dallim prej rreth 41 mijë eurosh. Një tjetër produkt për të cilin ka dallime të mëdha në është edhe ampula Fentanyl. Ky medikament është anestetik opioid. Përdoret si analgjetik gjatë operacioneve, si depresant respirator, si analgjetik pas operacioneve, si dhe në dhimbje persistente kronike të sëmurët me kancer<sup>5</sup>. Mesatarisht në SHSKUK nga kjo lloj ampule shpenzohen 64620 njësi. MSH-ja, në vitin 2015, këtë lloj ampule e ka paguar 0.37 euro. Në kontratën e fundit të vitit 2016, ky produkt është kontraktuar me 0.95 euro. Kësisoj nëse bazohemi në planifikimin e njëjtë në kontratat paraprake, kjo ampulë i ka kushtuar shtetit 23 mijë e 909 euro brenda një viti. E njëjta sasi, për të njëjtin produkt nga e njëjta kompani prodhuese e nga e njëjta kompani distribuese (shpërndarëse), tash MSH-së i kushton 67 mijë e 389 euro. Kontrata tre-vjeçare e këtij produkti në të kaluarën ka kushtuar 71 mijë e 727 euro, ndërsa kontrata aktuale për një periudhë tri vjeçare kushton 213 mijë e 167 euro. Dallimi për të njëjtin produkt e të njëjtën sasi, është rreth 123 mijë euro.

<sup>3</sup> Intervistë e ministrit, Uran Ismaili për këtë raport

<sup>4</sup> Regjistri i barnave 2 (Prodhim i Shoqatës Farmaceutike të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë)

<sup>5</sup> Regjistri i barnave 2 (Prodhim i Shoqatës Farmaceutike të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë), faqe 177

Propofoli është një tjetër bar që ka pësuar ngritje astronomike të çmimit. Propofoli është medikament i përgjithshëm anestetik. Përdoret për induktimin dhe mbajtjen e anestezisë së përgjithshme, si dhe sedatimin e pacientëve të intubuar në kujdesin intensiv <sup>6)</sup>. Brenda një viti, SHSKUK-ja ka nevojë për 39 mijë e 030 njësi <sup>7)</sup>. Çmimi i këtij produkti në vitin 2015 për kontraktim në Spitale Publike ka qenë 4.60 euro. Në kontratën e vitit 2016, i njëjti produkt kushton 18 euro e 20 cent. Kështu, nëse në vitin 2015 janë shpenzuar 179 mijë e 538 euro për këtë produkt, në vitin 2017 shpenzohen 719 mijë e 346 euro. Nëse këto vlera llogariten për një periudhë tri-vjeçare, del se me kontratën e vjetër për tre vjet janë shpenzuar rreth 538 mijë euro, ndërsa me kontratat aktuale, për një periudhë tri-vjeçare për produktin e njëjtë, shpenzohen mbi 2 milionë euro. Pra, me kontratën aktuale për të njëjtin produkt, e me të njëjtën sasi MSH-ja i ka shpenzuar ose do t'i shpenzojë rreth 2 milionë euro më shumë. Aciclovir është një tjetër produkt që ka pësuar ngritje të çmimit. Ky produkt është një antiviral shumë aktiv, që përdoret me së shumti për trajtimin e herpeseve të lëkurës <sup>8)</sup>. Deri në vitin 2016 ky produkt nga MSH-ja është blerë me çmimin 2.95 euro. Nga viti 2017 i njëjti produkt blihet me çmimin prej 9 eurove. Brenda një viti shpenzohen 698 njësi. Me çmimin e vjetër MSH-ja në vit për këtë produkt shpenzonte rreth 2100 euro, ndërsa me çmimin e ri shpenzon rreth 6 mijë e 300 euro, pra afër 4 mijë euro me shumë. Rritje të çmimeve ka pësuar edhe produkti Morphine (i njohur si morfinë). Morfina është një analgjetik i fuqishëm. Morfina është analgjetiku i zgjedhur në kontrollin e dhimbjes që shoqëron infarktën akut të miokardit dhe kancerin. Bënë qetësim të dhimbjeve mesatare deri të ato të rënda që nuk mund të kontrollohen nga analgjetikët e tjerë <sup>9)</sup>. Brenda një viti nga SHSKUK-ja shpenzohen 9204 njësi. Ky produkt nga viti 2015, ka shënuar rritje për rreth 300 për qind. Përderisa në vitin 2015 është blerë me çmimin 0.85 euro për njësi, aktualisht për këtë bar paguhet 2,50 euro. Kjo nënkupton që në vitin 2015 janë shpenzuar 7832 euro ndërsa në vitin 2016 23 mijë euro. Nga kjo del se para vitit 2016, MSH-ja ka paguar për tri kontrata në vlerë të rreth 20 mijë eurove për këtë produkt, aq sa e paguan tash për një vit. Rocuronium Bromide është produkt i Listës Esenciale. Efekti i parë i këtij produkti është mioreleksant (relaksant i muskujve). Brenda një viti, MSH-ja blen 9413 produkte. Deri në vitin 2016, ky produkt nga MSH-ja është paguar 3.90 euro. Nga viti 2016 i njëjti produkt, nga firma e njëjtë paguhet 12 euro e 90 cent. Nëse bëhet llogaritja sasisë me çmimin e blerjes deri në vitin 2016 atëherë del se MSH-ja ka paguar vetëm për këtë produkt brenda një viti 36 mijë e 710 euro, por me ngritjen e çmimit, del se MSH-ja nga viti 2015, paguan 121 mijë e 427 euro, që i bie që vetëm brenda një viti nga blerja e këtij produkti humb rreth 80 mijë euro. Protamin Sulphate është një produkt spitalor që përdoret para dhe pas operacionit dhe pas procesit të hemodializës. Deri në vitin 2016, çmimi i këtij produkti të cilin e ka blerë MSH-ja ka qenë 4.66 euro, rreth dy vite me parë çmimi i këtij produkt është rritur në 18 euro e 20 cent. Pasi që ky produkt është specifik dhe nuk përdoret shumë një pjesë e vogël e buxhetit i dedikohet këtij produkti. Konkretisht deri në vitin 2016 brenda një viti për këtë produkt mesatarisht janë shpenzuar 2 mijë e 665 euro. Por me trendin e ndryshimit të çmimeve, vlera e parasë se shpenzuar nga MSH-ja për këtë produkt është 10 mijë e 410 euro. Pra vetëm për një vit dallimi është rreth 8 mijë euro me shumë. Rritje astronomike ka edhe produkti Noradrenaline. Ky produkt deri në vitin 2016 nga Ministria e Shëndetësisë është blerë 2.78 euro. Aktualisht, ky produkt blihet 22 euro. Deri në vitin 2016 nga buxheti i shtetit janë paguar 1918 euro, por pas rritjes së çmimit përreth 900 fish, tash MSH-ja paguan për këtë produkt mbi 15 mijë euro.

<sup>6)</sup> Regjistri i branave 2 (Prodhim i Shoqatës Farmaceutike të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë), faqe 369


<sup>7)</sup> Nga tabela e MSH-së e planifikimit vjetor për furnizim me barna për vitin 2016

<sup>8)</sup> Regjistri i barnave 2 (Prodhim i Shoqatës Farmaceutike të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë), faqe 19

<sup>9)</sup> Po aty


Një produkt tjetër i përdorur shpesh në spitalet publike të Kosovës është produkti Impenem Cilastatinë është antibiotik. Brenda vitin në SHSKUK shpenzohen 9 mijë ampula. Çmimi deri në vitin 2016, për këtë produkt ka qenë 5.50 por tash është rritur në 12.50 euro. Nga llogaritja del se me çmimin e vjetër MSH-ja ka paguar për këtë produkt 50 mijë euro brenda një viti, por me ndryshimin e çmimit, MSH-ja për sasinë e njëjtë paguan 112 mijë e 500 euro. Produkti Tropicamid janë pika për sy. Brenda një viti, në SHSKUK shpenzohen 1305 produkte. Çmimi i tyre deri në vitin 2016 ka qenë 2 euro. Instituti Columbus ka gjetur se tash këto pika blihen në vlerë të 15 eurove. Nga llogaritja që i ka bërë Columbus, bazuar në çmimet e dy kontratave të fundit publike të këtij raporti, atëherë del një dallim i madh në mes të dy kontratave. Në kontratën e kaluar, brenda një viti, për këtë produkt shpenzoheshin 2610 euro, ndërsa me kontratën aktuale vetëm për një vit shpenzohen 19 mijë e 575 euro. Ampula Vitamin C është një nga produktet me të përdorur në SHSKUK. Çmimi i këtij produkti deri në vitin 2016, me të cilin e ka blerë MSh-ja këtë produkt, është 0.13 euro. Aktualisht, blihet me çmimin 0.50 euro. Për Vitaminën C, deri vitin e kaluar, janë shpenzuar për një vit 8 mijë e 243 euro, ndërsa aktualisht paguan 31 mijë e 700 euro.

## % e rritjes së çmimit - barnat




(TABELA 1)

## Krahasimi mes kontratash - barnat



(TABELA 2)

## Diferenca për çmime për njësi mes kontratash - barnat




(TABELA 3)



# Rritja astronomike e materialit shpenzues

Përveç në barna, rritje astronomike të çmimeve nga viti në viti ka pasur edhe për produktet që i takojnë materialit shpenzues. Instituti Columbus ka krahasuar edhe ndryshimet e kontratave nga viti në vit dhe ka rezultuar që në disa artikuj të Materialit Shpenzues u janë rritur çmimet për gati 26 fish. Kjo nënkupton shumë humbje për produktet të cilat edhe në çmimin privat e edhe me herët kur janë blerë nga MSH-ja, kanë kushtuar lirë. Instituti Columbus në pjesën narrative do të demonstrojë disa raste, ndërsa e plotë me të gjitha barnat dhe me produktet e materialit shpenzues do t'i bashkëngjitë në një aneks të veçantë. Një nga produktet që ka rritur çmimin mënyrë astronomike është T – Drain Latex i cili nga SHSKUK-ja blihet në 7 madhësi si në vijim : 8 FG, 10 FG, 12 FG, 14 FG, 16 FG, 18 FG dhe 20 FG <sup>10</sup>. Këto lloje të produkteve të përmasave të ndryshme, SHSKUK-ja i përdor 1267 të të gjitha llojeve brenda një viti. Në këtë mënyrë, sipas llogaritjes dhe krahasimit të çmimeve të dy kontratave të fundit, del që MSh-ja paguan 21, 539 euro, në vend se të paguajë 760 euro si në kontratat paraprake.



(Fotoja është ilustrim për produktin)

Një tjetër produkt, edhe pse përdoret në sasi të vogël në SHSKUK, ka shënuar rritje marramendëse sipas gjetjeve të Institutit Columbus. Bëhet fjalë për produktin "Parenkima Sutura Set". Deri në vitin 2016, ky set është blerë me çmim prej 3.83 eurosh. Në kontratën e fundit, ky produkt është blerë 83 euro. Në kontratën e kaluar ky produkt i ka kushtuar MSH –së 91.20 euro, për të njëjtën sasi penjtë për eshtrat e kokës MSH-së do i kushtojnë 2000 euro pra 1900 euro me pak se e njëjta sasi vitin paraprak. Një tjetër produkt që ka pësuar ndryshime të mëdha është edhe produkti "Suture Non Absorbable Monofyl Polypropilen". Ky produkt ekziston në 23 përmasa të ndryshme. Çmimi i tij varësisht nga përmasa ka nisur nga 0.35 euro në vitin 2015. Aktualisht, ky blihet rreth 700 për qind me shtrenjtë, konkretisht rreth 2 euro e 30 cent.

(Fotoja është ilustrim për produktin)




<sup>10</sup> Të dhënat janë nxjerrë nga Plani Vjetor i miratuar nga MSH për vitin 2017

Tjetër produkt që është shtrenjtuar kur bëhet fjalë për pajisje mjekësore. Sclep Handle (Skalperi i dorës) nga 0.10 cent në vitin 2015 tash blihet 1 euro nga MSh-ja, pra rreth 900 përqind me shumë.




(Fotoja është ilustrim për produktin)

## Diferenca për çmime për njësi - materiali




## Rritja e çmimit me përqidje - materiali



(TABELA 2)

## Çmimet krahasuese me kontratash - materiali



(TABELA 3)

# Shteti legjitimoi monopolin

Nga viti 2014, në Ministrinë e Shëndetësisë ka ndryshuar struktura e kompanive që kanë fituar tenderë. Kryesisht kanë pasur trend të rritjes kompania Liri Med dhe Kompania Exclusive. Këto dy kompani, kanë tenderët për 60 për qind të Listës Esenciale. Këto kompani, si përfituese të miliona eurove në vit, nga viti 2016 kanë filluar rritjen e çmimeve pa ndonjë arsytim. Një gjë të tillë ua ka lejuar një lloj monopoli që është krijuar me ndryshimin e ligjeve dhe udhëzimeve administrative që lidhen me fushën e barnave. Deri në vitin 2015, Ligji për Produkte dhe Pajisje Mjekësore ka lejuar që një bar ose produkt nga materiali shpenzues të mund të marrë pjesë në tender publik, nëse produkti është i regjistruar dhe në qarkullim në vendet e Bashkimit Evropian <sup>11</sup>). Në vitin 2015, është nxjerrë Udhëzimi Administrativ për Marketing Autorizim. Legjislacioni i ri ka ashpërsuar kriteret. Përveç që kërkon që ky bar të jetë i regjistruar në shtet e BE-së duhet të kalojë në procedurë të marrjes së certifikatës së Marketing Autorizimit edhe në Kosovë <sup>12</sup>). Kësisoj, asnjë produkt nuk mund të marrë pjesë në tender publik pa u regjistruar dy herë. Kjo, sipas Shoqatës së Distributorëve Farmaceutikë, e ka rritur çmimin, pasi që jo të gjitha kompanitë paguajnë tarifën e regjistrimit të një produkti edhe në AKPM. Sipas kësaj shoqate, MSH-ja nuk duhet ta vendosë kriteret Marketing Autorizimit.

Kompanitë Farmaceutike nuk rrezikojnë që të paguajnë tarifa për barna që duhet t'i futen procedurave të tenderimit, për shkak se nëse nuk arrijnë të fitojnë tenderin, malli u mbetet i bllokuar në depo dhe rrezikojnë që t'u skadojë afati. Sipas Shoqatës së Distribuesve nëse në procesin e prokurimit lejohen produktet që qarkullojnë në BE, çmimet do të bien dukshëm <sup>13</sup>). Në anën tjetër, Ministria e Shëndetësisë është e gatshme t'i futet ndryshimit të këtij ligji, nëse ky ndryshim e zgjedh problemin. Ky institucion është i mendimit se nëse del që ndryshimet ligjore të bëra në fushën farmaceutike e kanë dëmtuar financiarisht MSH-në, kjo bazë ligjore do të ndryshohet <sup>14</sup>). Por, kompanitë mohojnë që kanë rritur çmimet duke shfrytëzuar monopolin e krijuar nga shteti. Fajin ua kanë hedhur fabrikave të cilat i kanë rritur çmimet e barnave kudo në botë <sup>15</sup>). Ngritja e çmimeve të barnave nënkupton vlerë në para të njëjtë të shpenzuar, por me shumë më pak furnizim. Ligji i Shëndetësisë nr. 2004/4 përcakton që buxheti i qeverisë duhet të përdoret për blerjen e barnave nga lista esenciale e barnave (LEB) e përkufizuar në regjistrin zyrtar dhe se kjo listë e barnave do të ofrohet në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor. Në Ligjin për Shëndetësi nr. 2012/04-L-125, neni 3, Përkufizimet 1.16, përkufizon që "Lista e barërave dhe materialit shpenzues" është Lista e produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese që mbulohen nga Qeveria dhe bashkë-pagesat e qytetarëve. Mbipërfshirja dhe nënpërfshirja janë tregues të korrupsionit të mundshëm. Mbipërfshirja ka të bëjë me përfshirjen e barnave të shtrenjta në listë (numri i tepërt i statinëve, për shembull), ose nënpërfshirjen e opsioneve efektive, më të lira të barnave. Kompanitë farmaceutike mund të paguajnë rryshfete, në mënyrë që barnat e tyre të shtohen në listë ose të përjashtohen barna të lira konkurrense <sup>16</sup>).

<sup>11</sup> [http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/2013-\\_04-L-190-Ligji-p%C3%ABr-produkte-dhe-pajisje-medicinale.pdf](http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/2013-_04-L-190-Ligji-p%C3%ABr-produkte-dhe-pajisje-medicinale.pdf)

<sup>12</sup> [http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/2013-\\_04-L-190-Ligji-p%C3%ABr-produkte-dhe-pajisje-medicinale.pdf](http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/2013-_04-L-190-Ligji-p%C3%ABr-produkte-dhe-pajisje-medicinale.pdf)

<sup>13</sup> Intervistë me farmacistin, Milaim Abdullahu

<sup>14</sup> Deklaratë e ministrit, Uran Ismaili në tryezën e Institutit Columbus

<sup>15</sup> Bisedë me pronarin e kompanisë "Exclusive", Burim Shkodra

<sup>16</sup> [file:///C:/Users/HP/Downloads/UNDP%20SAEK%20Corruption%20Risk%20Assessment%20in%20Health%20December%202014%20-%20Alb%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/HP/Downloads/UNDP%20SAEK%20Corruption%20Risk%20Assessment%20in%20Health%20December%202014%20-%20Alb%20(1).pdf)

Duke marrë parasysh buxhetin cili i ndahet MSH-së nga MEF, të shprehur në përqindje të GDP-së së vendit, Kosova bën pjesë në vendet me përqindjen më të ulët të buxhetit për shëndetësi (rreth 2.3% e GDP), krahasuar me shtetet e rajonit 5-7% e GDP apo me shtetet evropiane 10% e GDP që përbëjnë buxhetin për shëndetësi <sup>17</sup>). Keqpërdorimi i këtij buxheti edhe ashtu të varfër, rrezikon shërbimet shëndetësore dhe i vë sallat operative në kolaps. Një gjë e tillë ka ndodhur këto vite herë pas here në QKUK.

## Problemet në OSHP

“Salbutamol” është solucion që përdoret për procedurat e inhalimit. Në barnatore private ka çmim rreth 1.50 euro, viteve të kaluara është blerë me çmim prej 1.88 euro, ndërsa këtë vit MSH-ja e ka përzgjedhur kompaninë fituese me çmim prej 4.50 eurosh. Në të njëjtën formë ky institucion e ka përzgjedhur fitues edhe për produktin mjekësor “Sodium Valproat”. Llogaritja e çmimit bëhet me tabletë. Çmimi i tabletës në tregun privat është rreth 10 cent. Deri këtë vit, MSH-ja e ka blerë një tabletë “Sodium Valproat” me çmim prej 11 cent, ndërsa në tenderin e fundit MSH-ja fitues e ka përzgjedhur kompaninë që këtë produkt e ka ofertuar 0.99 cent <sup>17</sup>). Gjykata e Tenderëve - siç njihet ndryshe Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik - të dyja këto aktivitete të prokurimit i ka cilësuar si të jashtëligjshme. “Paneli Shqyrtues, po ashtu, mori parasysh edhe çmimoren – listën referente të publikuar në web-faqen e KRPP-së (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik) ku çmimi i produktit të kërkuar nga MSH-ja është 0.11 cent, ndërsa çmimi i produktit të ofruar është 0.99”, thuhet në vendimin e OSHP-së. Të jashtëligjshëm e ka konsideruar OSHP-ja edhe tenderin e blerjes së solucionit Salbutamol. Ky institucion e kishte kthyer edhe një herë këtë tender në rivlerësim. Megjithatë, MSH-ja kishte vendosur njëjtë. OSHP-ja tash po pretendon se ky tender duhet të kthehet prapë në rivlerësim, për t’ia dhënë mundësinë MSH-së që të përzgjedhë një tjetër kompani fituese që do të mund të kursente buxhetin e barnave. “Gjatë seancës, Autoriteti Kontraktues (që në këtë rast është Ministria e Shëndetësisë) nuk ka ofruar argument që çmimi që e kanë përzgjedhur është më i lartë se çmimi në treg”, thuhet në vendimin e OSHP-së kur e ka kthyer tenderin në rivlerësim. Sipas OSHP-së, në të dyja rastet MSH-ja ka shkelur nenin katër të Ligjit të Prokurimit Publik. “Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit dhe përzgjedhjes së kontraktorit, Autoriteti Kontraktues është i obliguar që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut”, thuhet në këtë ligj. QKUK-ja që llogaritet si qendra më e madhe spitalore publike këto blerje i cilëson si fajtores për kolapsin me barna. “Pyetja rreth ndryshimit të Ligjit për Produkte dhe Pajisje Mjekësore po ashtu mendojmë se është pyetje që do të duhej t’i parashtrohet AKPM-së, përderisa besojmë që jeni të informuar se këto ndryshime janë të vërteta, kanë rezultat me rritje drastike të çmimeve, siç vërehet nga kontratat që ka lidhur Ministria e Shëndetësisë. Mund t’ju konfirmojmë se ndikimi total brenda një viti, Institucioneve tona ju kushton rreth 3 milionë euro dhe kjo shifër po shtohet vazhdimisht, është në rritje me lidhjen e kontratave të reja, që po lidhen për llogari të furnizimit vjetor të Institucioneve Shëndetësore Publike, për furnizimet me barna nga Lista Esenciale”, thuhet në përgjigjen e këtij institucioni. Gjykata e Tenderëve - siç njihet ndryshe Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik - të dyja këto aktivitete të prokurimit i ka cilësuar si të jashtëligjshme. “Paneli Shqyrtues, po ashtu, mori parasysh edhe çmimoren – listën referente të publikuar në web-faqen e KRPP-së (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik) ku çmimi i produktit të kërkuar nga MSH-ja është 0.11 cent, ndërsa çmimi i produktit të ofruar është 0.99”, thuhet në vendimin e OSHP-së.

<sup>17</sup> <http://msh-ks.org/ëp-content/uploads/2013/11/Lista-Esenciale-sipas-VEN-dhe-ABC-Indikatoreve.pdf>

<sup>18</sup> [https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/273-17urdh\\_1.PDF](https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/273-17urdh_1.PDF)

